

AKTI I THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Check Point Agency” SH.P.K.

Durres, me 24.02.2025

Sot, me date 24.02.2025, ditën e Hene ne ora 11.00.

1. Znj. Elona Dervishi, emri i babait **Nazmi Dervishi**, lindur ne Tirane me 22.11.1982 dhe banuese ne Lagja 5, Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës, me ID nr. I26122050J, Shtetase Shqiptare, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar

2. Znj. Eni Hasa, emri i babait Seid Hasa, lindur ne Tirane me 30.09.1992 dhe banues ne Rr.Fatmi Haxhia, Tirane, ID nr. J25930036O, Shtetase Shqiptare, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar,

Te cilat deklarojne se me dëshirën e tyre te lire dhe vullnet te plote dhe te pa vesuar te redaktojne kete Akt Themelimi te shoqërisë **“Check Point Agency” Sh.p.k.** Ne Baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 1

THEMELIMI

Formohet shoqëria **“Check Point Agency” Sh.p.k.** Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët e mundeshe te se njëjtës do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do te ketë selinë dega. Shoqëria do te ushtroje veprimtarinë e saj ne baze te këtij akti themelues dhe statutit te shoqërisë te miratuar nga ortaket.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë “Nr. Pasurie 37/60-Nd, Zona kadastrale 3101, Qerret- Kavaje”.

Marrdhenia me qiradhenesin do te formalizohet pas themelimit dhe marrjes se NIUS te shoqerise.

AKTI I THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Check Point Agency” SH.P.K.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i shoqërisë është:

Veprimtari në fushën e shërbimeve si agjensi doganore, speditonere dhe shërbimeve portuale në përgjithësi për vetë dhe të tjerë. Shërbim transporti brenda dhe jashtë vendit si me mjetet e veta ashtu dhe me mjetet e të tjerëve. Konsulencë për legjislacionin fiskal, ekonomik si dhe konsulencë për investime brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme financiare dhe tregtare. Agjensi imobiliare, import eksport dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, industriale dhe automjeteve. Projektim dhe ndërtim të objekteve civile, industriale. Veprimtari komisionere, ndërmjetësi. Ndërmjetës në sigurime dhe agjent sigurimesh, etj.

NENI 4

MENYRA E KRYERJES SE AKTIVITETIT

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të bashkëpunojë me persona fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj.

NENI 5

LLOGARITE BANKARE

Shoqëria do të ketë llogarite e saja bankare në monedhën lokale (ALL) dhe çdo monedhë të huaj të konsideruar të arsyeshme nga ortaket, pranë bankës Banka Kombëtare Tregtare ose çdo banke tjetër e nivelit të dytë e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQERISE

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë **PA AFAT**. Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB).

AKTI I THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Check Point Agency” SH.P.K.

NENI 7

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqërisë tregtare private “Check Point Agency” Sh.p.k. do të jetë **100.000 ALL** (njqindmije) i ndare në **2 (dy)** kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhteme:

1. **Znj. Elona Dervishi**, emri i babait **Nazmi Dervishi**, lindur në Tiranë me 22.11.1982 dhe banuese në Lagja 5, Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës, me ID nr. I26122050J, Shtetase Shqiptare, zotëron **1 kuota**, të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë **me vlerë monetare 50.000 ALL (pesedhjetemije)**,
2. **Znj. Eni Hasa**, emri i babait **SeidHasa**, lindur në Tiranë me 30.09.1992 dhe banues në Rr. Ftmikr Haxhia Tiranë, ID nr. J25930036O, Shtetase Shqiptare, zotëron **1 kuota**, të barabartë me 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë **me vlerë monetare 50.000 ALL (pesedhjetemije)**.

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të shtohet ose pakësohet dhe është tërësisht i likuidueshem dhe i nënshkrueshem.

NENI 8

SEKRETI I AKTIVITETIT

Ortakët e shoqërisë angazhohen me detyrën për të shtuar volumnin e veprimtarisë së shoqërisë, të respektojnë detyrimin e ruajtjes së sekretit të saj lidhur me tipologjinë e aktivitetit të saj tregtar, si dhe marrin angazhim të mos themelojnë në Shqipëri aktivitete të tjetër që të jete konkurrues me objektin e “Check Point Agency” Sh.p.k.

NENI 9

DREJTIMI I SHOQERISE

Organet drejtuese të Shoqërisë do të jete:

- Asambleja e përgjithshme e Ortakëve do të jete i vetmi Organ vendimarrës i Shoqërisë.
- Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizike si Administratore të shoqërisë.
- Afati maksimal i emerimit të Administratoreve është 5 vjet me të drejtë riperteritje

AKTI I THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Check Point Agency” SH.P.K.

- Administratoria e emeruar nga asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte:

Znj. Eni Hasa, emri i babait Seid Hasa, lindur ne Tirane me 30.09.1992 dhe banues ne Rr. Fatmir Haxhia, Tirane, ID nr. J25930036O, Shtetase Shqiptare, per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rinovimi.

NENI 10

FITIMET

Viti financiar nis ne date 1 Janar te cdo viti dhe perfundon ne daten 31 Dhjetor te te nejtit vit. Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakeve te saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet.

NENI 11

ASAMBLEJA

Asambleja e përgjithshme emëron dhe revokon administratorin ne fuqi dhe mund te emëroje edhe administratore te tjerë me detyra te përcaktuara me ligj.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e parashikuara me ligj, për administrimin e ditëpërditshëm te shoqërisë, te përfaqësoje shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet me përjashtim te kompetencave qe vete ligji apo statuti ua jep shprehimisht ortakeve.

Për çështje te rëndësisë se veçante administratori konsultohet me ortaket dhe merr masat e përcaktuara nga asambleja e ortakeve, te marra me mazhorancat e parashikuara me ligj.

NENI 12

JURISDIKSIONI KOMPETENT

Për te gjitha konfliktet qe mund te lindin midis palëve do te jete kompetent legjislacioni ne fuqi i Republikës se Shqipërisë. Juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

NENI 13

VULA

Shoqëria ka vulën e vet dalluese me përmasa te zakonshme, te krijuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe mund te ketë një marke te sajën.

AKTI I THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Check Point Agency" SH.P.K.

NENI 14

HYRJA NE FUQI E AKTIT TE THEMELIT

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanërisht te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

NENI 15

DISPOZITA E FUNDIT

Ky akt-themelimi i shoqërisë "Check Point Agency" Sh.p.k. u hartua ne baze te vullnetit te lire te themeluesve, ne mbështetje te dispozitave përkatëse te Kodit Civil , Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", te akteve te tjera ligjore dhe nënligjore te ligjit " Për Noterinë" dhe baze te nenit 51 te këtij ligji, hartohet ne 3 (tre) ekzemplare origjinale, qe konsistojne ne 5 (pese) faqe, ku një qëndron pranë selise se shoqerise dhe dy te tjera i dorëzohen ortakeve te shoqërisë.

ORTAKET e SHOQERISE

"Check Point Agency" Sh.p.k

Znj. Elona Dervishi

Znj. Eni Hasa